



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prifato Received/Delivery	27-05-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3134/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.411/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.411/2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.05.2022, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej pesëmbëdhjete ditësh(15) nga data e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e ankueses së datës 06.09.2021 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

II. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrativ që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.

II Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 21.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2320/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, për mosdhënien e gradës diplomatike në kuadër të Komisionit për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.04.2022 ka



proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit me datë 11.05.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2330/2022 të datës 22.04.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 22.04.2022; Emalin e datës 21.04.2022; Emalin e datës 15.04.2022; Kërkesën për gardë të datës 06.09.2021; CV- e ankueses; Letrën motivues; Akt Emërimit me numër 298 të datës 27.08.2019; Akt Emërimit me numër 253 të datës 03.09.2018; Formularin e Vlerësimit të Nëpunësve të Shërbimit të Jashtëm të datës 16.09.2020; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 18.09.2020; Vendimin me numër MPJ-ZSP 19/2020 të datës 19.02.2020; Vendimin e datës 19.02.2020; Vërtetimin me numër 2208/04 të datës 18.09.2020; Diplomën universitare me numër NR.3886 të datës 25.04.2012; Letër rekomandimin e datës 08.01.2018; Letër Rekomandimin e datës 01.06.2018; Certifikatën me numër 0607204; Shkresën e datës 31.03.2013; Certifikatën e datës 19.12.2019; Certifikatën datës 11.03.2020; Certifikatën për përfundimin e praktikës studentore të datës 16.09.2011; Certifikatën e datës 17.03.2011; Certifikatën e datës 10.02.2012; Shkresën e datës 02.07.2013; Shkresën e datës 30.05.2013; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Emalin e datës 07.09.2021; Emalin e datës 01.10.2022; Emalin e datës 20.12.2021; Emalin e datës 20.12.2021; Emalin e datës 30.03.2022; Akt emërimit me numër 298 të datës 22.08.2019; Emalin e datës 26.05.2022 me numër të protokollit 3056/2022; Vendimin me Nr.110/2022 të datës 12.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2530/2022 të datës 29.04.2022; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 2705/2022 të datës 11.05.2022; Vendimin me Nr.86/2022 të datës 15.03.2022; E-mailin zyrtar me numër të protokollit të datës 23.05.2022; E-mailin zyrtar të 20.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 19.05.2022; Procesverbalin e datës 08.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që lënda të kthehet në detyrim për shqyrtim dhe vendosje nga organi administrativ kompetent gjegjësisht Komisioni për Gradë dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit me nr. akti 298 të datës 22.08.2019 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në pozitën *Asistente Administrative* në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa e njëjta me Vendimin Nr.110 të datës 12.05.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik është transferuar në pozitën *Zyrtare Administrative* në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme i nxjerr sipas Rekomandimit të datës 24.01.2022 të Komisionit për Ristrukturim të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej, Kolegji nga shkresat e lëndës ka gjetur se organi i punësimit duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit nr.03/L-122 dhe nenit 12 paragrafi 4 dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ka shpallur ftesë për shprehje të interesit për gradim dhe bazuar në këtë thirrje të brendshme ankuesja me datë 07.09.2022 ka paraqitur kërkesë për gradim.

Pasi që ankuesja nuk kishte pranuar përgjigje nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë, e njëjta më datë 09.03.2022 ka parashtruar kërkesë për qasje në procesverbalin e Komisionit për Grada

dhe Disiplinë. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.86/2022 të datës 15.03.2022 ka lejuar qasjen në dokumente publike parashtrueses së kërkesës gjegjësisht ankueses ku e njëjta përmes emailit të datës 17.03.2022 ka pranuar procesverbalin nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Nga procesverbali i Komisionit për Grada dhe Disiplinë të datës 09.12.2021 përkatësisht sipas pikës 56 të procesverbalit rezulton së Komisioni në fjalë nuk kishte shqyrtuar aplikacionin e ankueses për arsye së e njëjta ka pozitë teknike-mbështetëse. E pakënaqur me mos shqyrtimin e aplikacionit ankuesja parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimin ankimor se Komisioni ka trajtuar gabimisht aplikacionin e ankueses duke e cilësuar si staf tekniko administrativ, me tej shton se ka plotësuar të gjitha kriteret për gradim.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimor ju referua dispozitave ligjore të nenit 28 të Ligjit Nr. 03/L-122 Për Shërbimin e Jashtëm me të cilat është përcaktuar se: *Dhënia e gradave 1. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës. 2. Përveç gradës ambasador, gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, ndërlydhur me këtë Rregullorja Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm konkretisht neni 12 paragrafi 2 ka paraparë se: Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlefshëmërinë e caktimit të gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore.*

Andaj, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 97 paragrafi 1 ku parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ....*, Kolegji duke u bazuar në faktin se Komisioni për Grada dhe Disiplinë nuk kishte ofruar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e ankueses të datës 07.09.2021 për gradim dhe meqenëse ekzistojnë rrethana të reja juridike lidhur me pozitën e ankueses sipas Vendimit Nr.110 të datës 12.05.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të DMZP-së, Kolegji për Shqyrtimin edhe Vendosjen e Ankesave vlerëson së janë plotësuar kushtet ligjore që Komisioni për Grada dhe Disiplinë të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 07.09.2021 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.411/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Proqesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj- Demi

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Komisionit për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

